

me ushqim dhe të vegjël (pasardhës), e shumë dhunti të tjera. Mëshira e All-llahut i mbulon ato deri në pikën që për shkak të një pjesë të vetëm nga mëshira e All-llahut që dërgoi në tokë, "... krijesat e Tij janë të mëshirishme me njëra-tjetërën, në mënyrë që edhe pela lagon këmbën që mos ta shtypë mëzin (të voglin e saj)." Krijuesi Mëshirues kujdeset për çdo krijesë - nga peshqit në thellësitet e oqeanit, insektet në tokë dhe zogjtë në qjell - të gjitha janë nën sundimin e Tij.

## Si ta shtojmë mëshirën e All-llahut ndaj nesh

... Mëshira e All-llahut është me të vërtetë afër mirëbërësve." Kur'an 7:56

përbërëse e të pasurit besim të drejtë është besimi dhe bindja në të dërguarin e fundit, Muhammedin (paqja qoftë mbi të).

Me pak fjalë, njerëzit që marrin më shumë nga mëshira e All-llahut janë ata që janë vetëdijësuar për dhunitë dhe të mirat e Tij, i kanë përdorur ato në atë mënyrë që i pëlqen Zotit, e kanë shpenzuar pasurinë që ua dha Zoti në bamirësi e përkujdesje për të varfërit, i kanë punësuar duart e tyre në përkujdesje për jetimet, e kanë shfrytëzuar dhunitinë e tyre në të folur për të këshilluar dhe për të folur në mënyrën më të mirë dhe kanë kryer punë të tjera të mira të pëlqyera nga Zoti.

Muhammedi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: "All-llahu do t'i mëshirojë ata të cilët i mëshirojnë njerëzit. Mëshiro ata që janë në tokë që Ai që është në qjell të të mëshirojë ty."

Në vijim janë disa nga mënyrat për ta fituar mëshirën e Zotit.

"E bindjuni All-llahut dhe të dërguarit, ashtu që të mëshiroheni." Kur'an 3:132

Duke ndjekur mësimet e mëshirës dhe drejtësisë që gjenden në Kur'an: "Dhe ky është libër, dobiprurës, Ne e zbritëm,

v1.00  
përbahuni këtij, ruajuni ashtu që të mëshiroheni."

Kur'an 6:155

"Falni rregulisht namazin, jepni zeqatin dhe respektoni të Dërguarin në mënyrë që të mëshiroheni." Kur'an 24:56

Kërkimi i mëshirës nga Zoti në mënyrë të sinqertë. "Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na i drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, pse vetëm Ti je dhurues i madh." Kur'an 3:8

## Mëshira dhe Përgjegjësitë

Krahas atributit të mëshirës së All-llahut është edhe atributi i Tij i Drejtësisë. All-llahu është mëshiruesi më i madh. "Është e sigurt se për të devotshmit do të ketë te Zoti i tyre kopshte të begatshme. A do ti bëjmë kriminel të barabartë me muslimanët? Ç'është me ju? Si gjykonit ashtu?" Kur'an 68:34-36

All-llahu është mëshiruesi më i madh, megjithatë, Ai është gjithashtu i shpejtë në llogari. Njeriu nuk mund të përpinqet të mashtrojë All-llahun dhe të përfitojë nga mëshira e Tij duke kryer mëkatet e njëjtë pa pendim të sinqertë ose pa vendosur që mos të kthehet përsëri në atë mëkat. "Nuk është pendim (i pranueshëm) i atyre që vazhdimisht bëjnë punë të këqia dhe vetëm atëherë kur t'i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, të thotë: "Unë tash u pendova!" e as i atyre që vdesin duke qenë jobesimtarë. Ndaj tyre kemi përgatitur dënim të ashpër." Kur'an 4:18

Muslimanët janë të inkurajuar që të kenë shpresën e shpërbimit për vepra të mira, duke qenë të shqetësuar për mëkatet që ata mund të kryejnë. Kur ata kryejnë mëkate, pendohen singerisht, duke shpresuar përfalje. Dhe së fundi, ata ndjehen të kënaqur me fjalët e Krijuesit të tyre, dhe i mbajnë ato afër zemrës së tyre. "S'ka dyshim se All-llahu është mirëbërës, mëshirues ndaj njerëzve." Kur'an 22:65

**Informacion**  
tel 045 633 370 web [islamifejaevertete.com](http://islamifejaevertete.com) @ broshurat@gmail.com  
Emri i bankës Pro Credit Bank  
Kontoja 1184001037000102 Swift MBKORS22

# Mëshira e All-llahut (Zotit)



gjërat  
themelore

[islamifejaevertete.com](http://islamifejaevertete.com)

**"Sa mëshirues i madh është ky Zoti i Juaj..."**

Kur'an 6:147

Zoti i Plotfuqishëm është përplot dashuri dhe mirësi ndaj krijesës së Tij. Të gjitha të mirat dhe mirësia në këtë botë janë dëshmi të qarta të mëshirës së Tij. Në të vërtetë, Islami na mëson se Zoti është më i mëshirshëm ndaj neshë se sa nënët tonë. Si mund të jetë ndryshe, kur disa nga emrat dhe cilësitetë e Tij janë:

- Pranuesi i Pendimit;
- Mëshiruesi;
- I Dashuri;
- Përdëllimtari (Ai që nuk ngutet për hakmarrje);
- I Gjithëmëshirshmi;
- Mëshirëbërësi;
- Mirëbërësi;
- Bujari;
- Dhuruesi

Të gjitha këto emra (cilësi) tregojnë se Zoti karakterizohet me mëshirë, mirësi dhe bujari. Ata dëshmojnë përfundësinë dhe përsosmërinë e mëshirës së Tij, me të cilën i përfshin të gjitha krijesat e tij. Krijesës së njejtë i drejtohet All-llahu kur thotë: "O biri i Ademit, sikur të më vije Mua me gjynahë sa madhësia e tokës duke më takuar pa më bërë Mua shok në adhurim asgjë. Unë do të vijë tek ti me falje sa madhësia e tokës."

## Shembuj të mëshirës dhe dhutive të All-llahut

*"E, cilën të mirë  
të Zotit tuaj po  
e mohoni?"*

Kur'an 55:13

Gjatë gjithë jetës së tyre njerëzit vazhdimisht përfshihen nga dhunitë e All-llahut, qoftë shëndet, shikim të mirë, dëgjim të mirë, ushqim, ajër të pastër, fëmijë, pasuri dhe gjëra të tjera të panumërtë. Disa nga njerëzit këto dhurata të Zotit - inteligencën dhe arsyen i përdorin për t'u vetëdijësuar për këto dhungi, ta kuptojnë qëllimin e ekzistencës së tyre, e në këtë mënyrë ia dorëzojnë veten All-llahut. Por ka të tjerë të cilët nuk e vlerësojnë mëshirën e

All-llahut ndaj tyre, Ai i ushqen dhe i mban gjallë edhepse ata nuk i binden Atij. Atyre u është dhënë liria e lëvizjes, kënaqësia, liria e mendimit dhe e punës, edhepse ata padrejtësisht e mohojnë Atë. Ata nuk do të ekzistonin nëse nuk do të ishte kjo mëshirë e madhe e All-llahut.

Përfundimisht, çdokush është i lirë që të vetëdijësohen për të mirat e tij dhe t'i përdorë ato në pajtim me urdhërat e All-llahut (Zotit të njerëzimit) dhe ta adhurojë vetëm Atë. Në vazhdim kemi theksuar një shembull nga Kur-an i përkthyer këtu:

**"... Në qoftë se ju numëroni dhunitë e All-llahut, nuk do t'i dilni dot në fund. All-llahu, pa dyshim fal dhe është shumë i mëshirshëm." Kur'an 16:18**

## Udhëzim përmes librave dhe pejgamberëve të mëhershëm

*"Ai ta zbret ty  
(Muhammed) librin me  
argument që është vërtetues i  
librave të mëparshëm. Ai e zbriti  
më parë Tevratin dhe Inxhilin."*

Kur'an 3:3

Prej fillimit të njerëzimit, njeriu nuk ishte i vetëm në ballafaqimet e jetës. Për shkak të mëshirës së All-llahut, Ai u zbriti ligje pejgamberëve të cilët ua treguan dhe ua mësuan njerëzve këto ligje për t'i udhëzuar dhe për t'i mbrojtura. Libri i fundit dhe më i mëshirshmi është Kur'an i pejgamberi i fundit qoftë Muhammedi (paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të).

Kur'an - Shpallja përfundimtare – zëvendësoi dhe shfuqizo shpalljet e mëparshme, dhe është mëshira dhe udhëzimi i fundit për njerëzimin. Ashtu si dërgoi të dërguar në të kaluarën, Zoti gjithashtu u dërgoi njerëzve një shembull të gjallë të përkryer dhe praktik se si mësimet e Kur'anit për mëshirën dhe drejtësinë duhet të zbatohen praktikisht në jetën tonë të përditshme. Ky shembull ishte Profeti Muhammed (paqja qoftë mbi të) - mëshirë për njerëzimin.

*"E Ne të dërguam  
ty (Muhammed) vetëm  
si mëshirë për të gjitha  
krijesat."*

Kur'an 21:107

Në vijim i kemi paraqitur vetëm disa nga thëniet e Pejgamberit të cilat janë tregues për mëshirën, mirëkuptimin, tolerancën dhe mësimet e tij të bukurë:

**"Nuk gjendet mirësia në ndonjë gjë, e të mos e zbukurojë atë, dhe nuk largohet ajo nga ndonjë gjë, e të mos e bëjë të mangët atë."**

**"Më i përsosuri prej besimtarëve në besim, është më i miri prej tyre në karakter."**

**"Nuk është musliman i vërtetë ai që ka barkun plot, kurse fqinji përkrah tij është i uritur."**

**"All-llahu nuk do ta mëshirojë atë i cili nuk i mëshiron të tjerët."**

Sa shumë na nevojiten ne, në këtë kohë, këto këshilla kaq të bukurë?

## Mëshirë ndaj krijesës

Krijimi i qenieve njerëzore me të gjitha specifikat që i kanë është një mëshirë e madhe në vetëvete. Fakti që ne mund të ngrihem nga shtrati, të punojmë, të hamë, të luajmë dhe të flejmë duhet të na bëjë mirënjojës. **"Dhe prej mëshirës së Tij, ua ka bërë juve natën dhe ditën, që të qetësoheni në të dhe të kërkoni nga dhunitë e Tij, - dhe që ju të jeni mirënjojës."**

Kur'an 28:73

Një bashkëshort është një nga mëshirat më të mëdha, një mënyrë për qetësi dhe dashuri. **"Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijo nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje te ato dhe në mes jush krijo dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë."**

Mëshirë nga All-llahu është edhe fakti se Ai na krijo ne pa mëkate dhe nuk do të na mbajë për llogari deri në moshën e pjekurisë dhe të vendimmarries.

Falja e mëkateve është një shembull tjetër nga mëshira e All-llahut. All-llahu e di më së miri për ne se nuk jemi të përsosur dhe bëjmë gabime. Fakti se besimtarët bëjnë mëkate nuk do të thotë se ne duhet ta humbin shpresën nga mëshira e All-llahut. **"Thuaj: "O robërit e Mij, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së All-llahut, pse vërtetë All-llahu i falë të gjitha mëkatet, është Ai që shumë falë dhe është mëshirues!"**

Edhe kafshët nuk janë të përjashtuara nga mëshira e All-llahut. Ato kanë organet e të dëgjuarit dhe të parit, janë të siguruara